



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:272357

Datë: 18.04.2024

Numri i dokumentit: 05591197

**AC-I-23-0251**

***Në ankesën e***

***Paditësi/Ankuesi***

**D G**, Prizren

Përfaqësuar nga **Avokat B I** Prishtinë.

***kundër***

***E paditura***

**NSH, "Famipa"** Prizren (në likuidim), të cilën e përfaqëson, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Dritan Hoxha" nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-15-1688 (2022:272357) të datës 13 prill 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 18 prill 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e paditëses është e bazuar.**
- 2. Ndryshohet Aktgjykimi i shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-15-1688 i datës 13 prill 2023, dhe Vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRZ024-0489, i datës 16 shtator 2013.**
- 3. Padia e paditëses aprovohet si e bazuar.**
- 4. Obligohet e paditura që paditëses, t'i paguaj shumën prej 1.250.00 euro në emër të ndërprerjes së parakohshme të**

**marrëdhënies së punës duke përfshirë interesin ligjor prej 10% në shumë prej 125 euro, dhe shpenzimet e përfaqësimit nga ana e Avokatit në shumë prej 208 euro, të gjitha sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.**

## **5. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

### **Rrethanat procedurale dhe faktike**

Me datë 10 shtator 2015, paditësja përmes të autorizuarit të saj, e ka dorëzuar një ankesë në DHPGJS dhe ka kërkuar që të anulohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRZ024-0489 i datës 16.09.2013 me të cilin ishte refuzuar si e pabazuar kërkesa e saj për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 1.250,00 euro, me arsyetim se e njëjta nuk ka qenë në listën e pagave në 6 muajt e fundit, nuk ka qenë punëtorë aktiv në NSH, andaj nuk i plotëson kushtet nga neni 40.1.6.2 i Shtojcës së Ligjit të AKP-së. Paditësja në ankesë ka pohuar ka qenë në marrëdhënie pune me NSH-në që nga data 01.02.1991 deri më 16.09.2011, gjithsej 20 vite, 7 muaj e 15 ditë, përvojë pune dhe sipas Ligjit i takojnë 6 paga. Tutje paditësja ka pohuar se ishte punëtoresh e NSH deri në ditën e privatizimit dhe marrëdhënia e punës iu ndërpre si shkak i veprimeve të AKP-së përmes një Vendimi duke e njoftuar për ndërprerje të menjëhershme të punësimit. Andaj ka kërkuar nga gjykata që të miratohet padia e saj si e bazuar, të obligohet AKP-ja që t'ia paguajë borxhin kryesor në shumë prej 1.250.00 euro në emër të borxhit për shkak të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës, duke kërkuar kamatën prej 341,63 eurove si dhe shpenzimet e përfaqësimit në bazë të tarifës së OAK-së në shumë prej 104 euro. Bashkë me këtë ankesë ajo ka dorëzuar: prokurën, Aktvendimin për punësim nr. 02/17 të datës 31.01.1991, vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës dërguar nga AKP-ja.

Me datë 31 mars 2023, AKP-ja e dorëzon mbrojtjen në ankesë. AKP-ja mbanë qëndrimin se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht. Tutje AKP-ja pohon se lista për 6 muajt e fundit para datës së nënshkrimit të kontratës së privatizimit e paraqitur nga menaxheri i NSH-së, nuk pasqyron ndonjë pagesë të kryer ndaj parashtresit të kërkesës. AKP-ja vëren se parashtresi i kërkesës nuk

ka qenë punëtorë aktiv i NSH-së kur është privatizuar NSH-ja, andaj i njëjti nuk është pushuar nga puna shkak i veprimeve të AKP-së siç parashikon neni 6.1 apo 6.2 i Ligjit të AKP-së. Në mbrojtën në ankesë ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar.

Me datë 13 prill 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS me Aktgjykimin C-IV-15-1688 (2022:272357) ankesën e paditëses e refuzoi si të pabazuar dhe vërtetoi vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Shkalla e I-rë e DHPGJS ka arsyetuar se pas shqyrtimit të provave të lëndës, pretendimeve dhe parashtrimeve të palëve në procedurë gjykata ka ardhur në përfundim se parashtruesja e padisë nuk ka qenë punëtoare aktive në NSH në momentin e likuidimit të NSH-së. Tutje shkalla e parë e DHPGJS-së ka pohuar se paditësja nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante për të dëshmuar se ka pasur të themeluar marrëdhënien e punës NSH dhe se i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të procedurës së likuidimit. Andaj në mungesë të dëshmive bazuar në nenin 322.1 dhe 2 të LPK-së si dhe nenit 54.1 lidhur me nenin 74 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

Me datë 04 maj 2023, paditësja (në tekstin e mëtejme ankuesja) në DHPGJS ka dorëzuar një ankesë të afatshme kundër Aktgjyimit të DHPGJS, C-IV-15-1688 të Shkallës së I-rë të DHPGJS të datës 13 prill 2023, për të gjitha bazat ankimore. Për më tepër në ankesë ankuesja pohon se ka qenë punëtorë më tepër se 20 vite dhe ndërprerja e marrëdhënies së punës i ka ardhur si rezultat i likuidimit të NSH. Tutje pohon se ajo i është përmbajtur Njoftimit të AKP-së dhe me datë 28.06.2013 dhe ka parashtruar kërkesën e saj lidhur me kompensim, e drejtë kjo e garantuar me Ligjin e Punës. Ankuesja ka pohuar se e drejta e saj nuk buron nga kontrata e punës së punëtorit me punëdhënësin, por është e garantuar me ligj dhe bazohet në vitet e përvojës së punës. Në ankesë ankuesja përmend disa raste të jurisprudencës së Kolegjit të Apelit. Në fund ankuesja nga Kolegji i Apelit ka kërkuar që ankesa e saj të miratohet në tërësi, të anulohet Aktgjykimi i ankimuar dhe të obligohet AKP që tja paguajë kompensimin e pagave në shumën e kërkuar, kamatën si dhe shpenzimet e përfaqësimit. Bashkë me ankesë ka sjellë kopjen e librezës së punës, njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës, vendimin e Autoritetit të Likuidimit, dhe kopjen e ankesës kolektive të dorëzuar në DHPGJS me datë 25 shtator 2013.

Me datë 29 qershor 2023, AKP-ja e dorëzon një parashtresë në DHPGJS dhe i përgjigjet ankesës së ankueses. Në këta parashtresë AKP-ja pohon se ajo e mbështet në tersi Aktgjykimin e ankimuar të Shkallës së I-rë të DHPGJS, ndërsa i kundërshton të gjitha pretendimet ankimore të ankueses si të pabazuara. Tutje AKP-ja pohon se ajo qëndron ende pranë gjitha thënieve dhe provave të paraqitura para Shkallës së I-rë të DHPGJS në rastin C-IV-15-1688, me të cilat AKP-ja i ka hedhur poshtë të gjithë pretendimet e paditëses në padinë e saj, dhe këto argumente nuk do të përsëriten më, ngase nuk shërbejnë për mbarëvajtjen e procedurës. Andaj nga këto arsye AKP-ja kërkon që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa e paditëses është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar Shkallës së I-rë të DHPGJS, nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të ndryshohet dhe padia të aprovohet si e bazuar.

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditëses e datës 28 qershor 2013 për kompensimin e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 1,250.00 euro, me vendimin PRZ024-0489 të datës 16 shtator 2013, refuzohet si e pa bazuar, me arsyetimin se paditësi nuk ishte listën e pagave të NSH-së 6 muaj para privatizimit të saj, dhe nuk ishte punëtorë aktiv.

Paditësja në ankesën e dorëzuar në DHPGJS me datë 10 shtator 2015 me të cilën ajo e konteston vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRZ024-0489, të datës 16 shtator 2013, ajo kërkon dëmshpërblim për shkak të largimit të saj nga puna si

rezultat i privatizimit të NSH-së, dhe atë 6 paga në bazë të përvojës së saj të punës, në shumë prej 1,250.00 euro.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së e ka refuzuar ankesën e paditëses si të pabazuar, duke vlerësuar se kjo kërkesë nuk i përmbush kriteret nga neni 40.1.6.1 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, pasi që ankuesja nuk ka sjellë dëshmi në mbështetje të ankesës, kontratë të punës të lidhur me ndërmarrjen, listë të pagesës të bërë në emër të pagave, Librezë të punës që do të dëshmonte se ka qenë në marrëdhënie punë me NSH-në dhe se marrëdhënia e punës i është ndërprerë për shkak të procesit të likuidimit të NSH-së.

Kolegji i Apelit konstaton se nuk ishte i drejtë përfundimi i shkallës së I-rë të DHPGJS-së, pasi që në bazë të përmbajtjes së ankesës është e qartë se paditësja kërkon kompensim të 6 pagave të pa paguara për shkak të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës.

Në këtë lëndë duhet vlerësuar nëse paditësja me provat e ofruara ka dëshmuar se i plotëson kriteret ligjore që të i njihet e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në bazë të nenit 40.1.6.2 të Shtojcës të Ligjit të AKP-së.

Paditësja në ankesën e saj ka pretenduar se ka punuar në NSH- deri në privatizimin e NSH-së me datë 16 shtator 2011. Këto pretendime ajo i ka mbështetur me kopjen e Librezës së punës e cila është dorëzuar në gjykatë, e mbyllur me datë 16.09.2011, dhe po ashtu edhe me njoftimin e AKP-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 16 shtator 2011, pastaj edhe prova të tjera të mjaftueshme.

Paditësja ka kërkuar 6 paga në shumë prej 1.250,00 euro, shumë të cilën AKP nuk e ka kontestuar as pranë shkallës së I-rë dhe as pranë Kolegjit të Apelit.

Kolegji i Apelit konstaton se AKP-ja e mban arkivin e NSH-së dhe ajo dëshmitë lidhur me pagat e punëtorëve të saj i ka në dispozicion, dhe nëse shuma e pretenduar prej ankueses nuk ka qenë e saktë, atëherë AKP-ja ka mundur ta kundërshtojë me ndonjë dëshmi se paga e saj ka qenë më e ultë nga ajo shumë që ajo pretendon.

AKP-ja ka dështuar të dorëzojë dëshmi të tilla, andaj Kolegji i Apelit e konsideron si fakt të provuar shumën prej 1.250,00 euro.

Prandaj nga këto arsye, Kolegji i Apelit vjen në përfundim se paditësja me dëshmitë e ofruara ajo ka provuar se i plotëson kushtet nga neni 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, që të i njihet e drejta në kompensim të 6 pagave të pa paguara në shumë prej 1.250,00 euro, në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, e cila pagesë do të bëhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Në bazë të nenit 37.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, paditëses i njihet edhe e drejta në interes ligjor prej 10%, në shumë prej 125,00 euro, ndërsa në bazë të nenit 62.2 të LDHP-së, paditëses i njihet e drejta e kompensimit të shpenzimeve të Avokatit në shumë prej 208 euro, të cilat shuma do të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Prandaj nga këto arsye, ankesa e paditëses është aprovuar si e bazuar, është ndryshuar Aktgjykimi i ankimuar dhe padia është aprovuar si e bazuar.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

### **Taksat gjyqësore**

Ankuesja tashmë ka paguar taksën gjyqësore në shumë prej 20 euro me datë 27.06.2023, andaj nuk do të caktohet taksë shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 18 prill 2024.

Mr.sc Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues

\_\_\_\_\_